# DËSHMI ARKIVI

**A-469113**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Inteligjenca Artificiale hyn në tregun imobiliar, shtëpitë nuk duken më si në realitet |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/hi-tech/inteligjenca-artificiale-hyn-ne-tregun-imobiliar-shtepite-nuk-duken-me-s-i588348` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 14:01:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 13:55:21 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `27d7ebefb4eb4a57e871db47e27daf67353ed82bc9df9d7e1d481be9bf92b7f9` |
| TEKSTI | `f97b00e4b56c1030cf2577825416b815fa3f0c3aa9659efe17e0b930a530b44c` |
| PAMJA | `305fccdea754871bad6514f1ea8263870b4f2b7263eaeb94c5b74a6ef8fa7c0d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `74062643b0eb31fbbe8735241d930e49689b1311e8b6a5e9c69213ff1163e3e1` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e5555023da` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/74062643b0eb31fbbe8735241d930e49689b1311e8b6a5e9c69213ff1163e3e1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Inteligjenca Artificiale hyn në tregun imobiliar, shtëpitë nuk duken më si në realitet

TemA
25 Shtator 2026, 15:55Hi-Tech TEMA



Fotot perfekte të shtëpive që dalin në shitje online nuk janë gjithmonë reale. Inteligjenca artificiale po përdoret gjithnjë e më shumë nga agjentët imobiliarë për të ndryshuar pamjen e banesave dhe për t'i bërë ato më tërheqëse për blerësit.

Mobilimi virtual nuk është diçka e re në tregun e pasurive të paluajtshme, por me AI procesi është bërë shumë më i shpejtë dhe më i lirë. Një apartament bosh mund të shfaqet në internet i mobiluar.

Problemi nis kur ndryshimet nuk kufizohen vetëm te mobilimi. Në disa raste, inteligjenca artificiale mund të bëjë që dhomat të duken më të mëdha.

Kjo ka ngritur shqetësime për blerësit, të cilët mund të krijojnë pritshmëri të gabuara për një pronë vetëm nga fotografitë online. Rreziku është edhe më i madh për personat që po zhvendosen në një qytet tjetër dhe nuk kanë mundësi ta vizitojnë banesën përpara blerjes.

Për këtë arsye, rregullat e reja të Bashkimit Evropian për transparencën e përmbajtjeve të krijuara me AI kërkojnë që imazhet e modifikuara të identifikohen qartë. Edhe fotografitë e banesave të ndryshuara pjesërisht me AI mund të përfshihen në këto rregulla.

Megjithatë, mbetet e paqartë se si do të kontrollohet në praktikë nëse një fotografi është manipuluar dhe nëse agjentët i kanë vendosur etiketimin e kërkuar.

Shkeljet e rregullave mund të sjellin gjoba deri në 15 milionë euro ose 3 për qind të xhiros globale. Ekspertët kërkojnë më shumë transparencë, në mënyrë që një fotografi e bukur të mos kthehet në një premtim të rremë për shtëpinë që blerësi do të gjejë në realitet.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[One Albania sjell inovacionin Wi-Fi 7 për internetin në shtëpi]

19:22 Hi-Tech

Google: Inteligjenca Artificiale depërtoi në sistemet e tre kompanive gjatë testit të sigurisë

18:15 Hi-Tech

[Pas Meta-s, edhe Snapchat paralajmëron kufizime të kohës së përdorimit për të miturit]

09:29 Hi-Tech

[IA në mësime? Pothuajse gjysma e nxënësve shqiptarë e përdorin çdo javë]

12:30 Hi-Tech

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.